



AL

JU KRUHET? ATËHERË DREJTOJUNI MJEKUT.

Stop infeksioneve seksualisht të transmetueshme.

Sëmundjet, që transmetohen gjatë seksit, quhen „infeksione seksualisht të transmetueshme“ (STI – sexually transmitted infections).

Nga infeksionet seksualisht të transmetueshme HIV është më i rëndi dhe mund ta shkaktojë Aids-in – sëmundjen e rënies së imunitetit. Infeksioni HIV është i trajtueshëm me terapi, por edhe sot e kësaj dite i pashërueshëm. Kjo do të thotë se është e nevojshme një marrje medikamentesh të forta përgjatë gjithë jetës.

Krahas Virusit HIV ekziston dhe një varg i tërë shkaktarësh të sëmundjeve që mund të barten gjatë seksit. Shumë nga këto infeksione kalojnë pa ndonjë simptomë. Infeksionet seksualisht të transmetueshme të pazbuluara ose të patrajuara mund të kenë pasoja të rënda, p.sh. edhe për pjellorinë (fertilitetin) e femrave dhe të meshkujve, si dhe për shëndetin e fëmijëve tuaj.

Mbrojtjen më të mirë nga infeksioni e ofron ndjekja e rregullave për seks të sigurt:

1. Të bësh seks gjithmonë me kondom.
2. Jo spermës dhe gjakut në gojë.

Shumica e infeksioneve tjera seksualisht të transmetueshme, përpos HIV-it, mund të trajtohen mirë, ose edhe të shërohen, në rast se zbulohen me kohë. Për të penguar përhapjen e mëtejshme të një infeksioni është me rëndësi që infeksionet të zbulohen. Për këtë shkak vlen dhe një rregull i tretë për seks të sigurt:

3. Në rast kruajtje, djegësimi ose rrjedhjeje (kullimi) – shkoni ke mjeku.

Të infektosh me një infeksion seksualisht të transmetueshëm nuk është turp – mirëpo është me rëndësi që sëmundjet të zbulohen dhe të trajtohen. Për këtë shkak, në rast se janë shfaqur simptoma, ose është bërë seks i pambrojtur, duhet shkuar për vizitë ke mjeku.

Në rast se mjeku ose mjekja konstaton një sëmundje seksualisht të transmetueshme, është me rëndësi që ta informoni lidhur me këtë fakt partneren, përkatësisht, partnerin tuaj.

Informacione të tjera:

www.aids.ch/shop/produkte/infomaterial/fremdsprachige/artikelliste_fremdspr.php?lang=d



check-your-lovelife.ch